



Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare



Komisioni Evropian*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT


1 SHKURT 2023

** Vrojtimet e besimit bashkëfinancohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato kaluan në programin e Komisionit Evropian për harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit.*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) vijoi prirjen rritëse në muajin janar, duke shënuar nivelin 106.3 (Grafik 1). Përmirësimi i TNE-së u përcaktua nga rritja e besimit në sektorin e shërbimeve dhe rritja e besimit konsumator. Në të kundërt, besimi në sektorët e industrisë, ndërtimit dhe të tregtisë, dha kontribut negativ në zhvillimet e TNE-së në janar (Grafik 2).

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Treguesi i besimit të industrisë (TBI) ra me 1.3 pikë përqindje në muajin janar, i ndikuar kryesisht nga vlerësimet në rënie për kontratat porositëse, si vendase ashtu edhe nga eksportet. Krahasuar me mesataren historike, niveli i treguesit është rreth 2.5 pikë përqindje më i lartë. Ndërkohë, bizneset vlerësojnë me rritje të lehtë prodhimin industrial, si dhe gjendjen e inventarëve. Pritjet e bizneseve për prodhimin në të ardhmen dhe për çmimet janë rritur (Tabelë 2, sektori i industrisë).

Treguesi i besimit në ndërtim (TBN) regjistroi rënie me 3.4 pikë përqindje në muajin janar. Megjithatë, niveli i tij mbetet ndjeshëm mbi mesataren historike, rreth 17.3 pikë përqindje më lart. Rënia në këtë muaj u ndikua si nga vlerësimi më i ulët për aktivitetin aktual të biznesit ashtu dhe nga niveli më i ulët i porosive. Bizneset e ndërtimit presin rënie të çmimeve të tyre në të ardhmen (Tabelë 2, sektori i ndërtimit).

Grafik 2. Treguesit e besimit sipas sektorëve*



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.


Shënim: *Grafiku paraqet vlera të standardizuara, për të korrigjuar ndryshimet ndërmjet mesatareve dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

Treguesi i besimit në shërbime (TBSH) vijoi prirjen rritëse për të katërtin muaj rresht, duke u rritur me 4.3 pikë përqindje në muajin janar. Si rrjedhim, niveli i tij vijon të mbetet ndjeshëm mbi mesataren historike, rreth 13.2 pikë përqindje më lart. Rritja e TBSH-së u ndikua nga vlerësimet pozitive për *ecurinë aktuale të biznesit* dhe për nivelin e *kërkesës*. Vlerësimet e bizneseve të shërbimeve për nivelin e *punësimit* nuk kanë ndryshime të ndjeshme nga muajt e kaluar. Pritjet e tyre për *ecurinë e çmimeve* në të ardhmen vlerësohen me rritje (Tabelë 2, sektori i shërbimeve).

Treguesi i besimit në tregti (TBT) ra me 1.1 pikë përqindje në muajin janar, por mbeti 1.2 pikë përqindje më i lartë se niveli mesatar. Bizneset e tregtisë vlerësuan me rënie *ecurinë aktuale të biznesit* të tyre, si dhe pritjet e *punësimit* (Tabelë 2, sektori i tregtisë). Gjithashtu, pritjet për çmimet në të ardhmen u vlerësuan me rënie.


Treguesi i besimit konsumator (TBK) vijoi të përmirësohet për të katërtin muaj rresht, duke iu afruar më shumë mesatares historike. Niveli i tij u rrit me 0.9 pikë përqindje në janar, duke qëndruar rreth 4 pikë nën mesataren historike. Rritja e TBK-së u ndikua nga pritjet më optimiste për situatën *ekonomike e financiare*, si dhe për *blerjet në shuma të mëdha* në të ardhmen (Grafik 2). Nga ana tjetër, vlerësimi për *blerjet e mëdha* gjatë muajve të fundit ishte me rënie. Pritjet për nivelin e përgjithshëm të çmimeve në të ardhmen janë rishikuar për lart këtë muaj.

Grafik 3. Situata e biznesit sipas sektorëve, gjatë muajve të fundit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për situatën e biznesit gjatë muajve të ardhshëm




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Pritjet për papunësinë dhe çmimet e konsumatorëve për 12 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Blerjet në shumë të mëdha të konsumatorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit e besimit sipas sektorëve*

	Vlerat			2022					2023	Situata aktuale	
	min	mes	max	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Koniunkturale**	Strukturore***	
Industri	-59.6	-111	6.0	-2.4	-6.9	-10.3	-7.2	-8.5	↓	+	
Ndërtim	-57.5	-25.9	-5.2	-10.8	-18.1	-10.6	-5.2	-8.6	↓	++	
Shërbime	-45.3	7	26.2	10.6	10.7	14.7	15.9	20.2	↑	+	
Tregti	-31.8	-1.4	17.8	3.0	0.8	1.7	3.6	2.6	↓	+	
Konsumator	-39.8	-26.6	-16.3	-35.7	-34.9	-33.6	-31.8	-30.9	↑	-	

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga muaji maj 2016.

***) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

****) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (--), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2. Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)

	2022								2023
	Maj	Qersh	Korr	Gusht	Shtat	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar
INDUSTRIA									
Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së)	28.1	28.0	20.6	18.4	16.9	12.3	9.3	13.7	14.2
Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së)	-14.1	-2.8	-8.4	-9.7	-8.1	-14.1	-17.5	-16.0	-17.8
Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së)	-17.2	-8.5	-6.9	-16.9	-15.9	-18.8	-22.6	-19.3	-21.9
Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4)	-5.9	-6.1	-6.2	-6.8	-0.3	-1.3	-3.8	-5.1	-2.3
Prodhimi pritje (pyetja 5)	30.1	25.6	29.8	34.2	31.0	32.1	33.7	35.0	33.4
Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6)	50.2	50.6	50.7	30.6	47.7	35.8	31.1	27.5	30.3
Punësimi pritje (pyetja 7)	17.8	14.6	13.4	9.7	9.4	10.8	7.1	6.6	6.8
NDËRTIMI									
Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së)	4.4	10.7	6.7	24.4	6.4	3.6	5.9	11.3	10.0
Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së)	-31.5	-28.1	-29.2	-34.7	-27.9	-39.8	-27.1	-21.6	-27.2
Punësimi pritje (pyetja 4)	5.3	7.5	4.8	21.6	12.1	7.7	16.9	7.8	11.2
Çmimet pritje (pyetja 5)	33.0	46.6	41.1	39.6	38.6	43.1	44.2	32.6	24.8
SHËRBIME									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së)	25.5	25.1	21.4	13.2	11.0	9.1	14.4	15.7	19.8
Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së)	27.0	27.1	16.5	12.4	10.3	12.3	14.9	16.1	20.6
Kërkesa pritje (pyetja 3)	36.7	36.5	35.3	24.9	31.2	20.8	26.2	26.0	32.1
Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4)	10.0	21.1	4.9	6.3	3.6	5.5	4.1	5.1	10.5
Punësimi pritje (pyetja 5)	12.7	6.2	7.6	8.6	14.8	5.5	7.9	6.1	6.2
Çmimet pritje (pyetja 6)	44.4	35.0	34.2	24.7	27.0	30.0	20.5	20.6	23.6
TREGTIA									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së)	14.1	12.8	11.3	2.7	5.2	-0.6	0.6	1.6	0.8
Gjendja e inventarëve (pyetja 2)	5.0	1.4	0.5	5.1	0.8	1.0	3.0	3.0	2.0
Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3)	13.3	15.7	21.1	11.9	11.9	14.6	17.9	21.9	23.9
Ecuria e biznesit pritje (pyetja 4)	14.5	23.4	22.1	15.7	17.9	15.8	22.9	28.0	27.3
Pritje për ecurinë e punësimit (pyetja 5, komponent i TBT-së)	3.8	2.8	1.7	0.5	0.8	2.1	2.8	5.7	4.3
Pritje për ecurinë e çmimeve (pyetja 6)	45.4	39.1	43.5	36.8	41.4	31.0	28.6	24.9	22.6
KONSUMATORI									
Situata financiare aktuale (pyetja 1)	-17.8	-18.4	-19.8	-15.8	-19.0	-21.3	-20.0	-20.4	-16.7
Situata financiare pritje (pyetja 2, komponent i TBK-së)	-6.3	-5.1	-7.1	-4.3	-4.3	-5.5	-3.8	-3.4	-2.6
Situata ekonomike aktuale (pyetja 3)	-31.2	-29.5	-32.2	-30.2	-32.1	-32.3	-31.7	-30.4	-27.9
Situata ekonomike pritje (pyetja 4, komponent i TBK-së)	-10.4	-12.6	-12.5	-6.3	-15.4	-13.3	-12.0	-9.2	-7.1
Çmimet aktuale (pyetja 5)	50.5	51.4	53.4	51.7	49.4	53.7	48.9	46.5	49.2
Çmimet pritje (pyetja 6)	3.5	5.9	2.7	0.1	3.4	2.9	-3.4	-10.4	-1.6
Papunësia pritje (pyetja 7)	10.6	10.2	10.3	9.3	12.5	14.5	8.5	10.9	9.8
Blerjet e mëdha aktuale (pyetja 8, komponent i TBK-së)	-68.9	-69.2	-66.6	-66.2	-68.1	-66.5	-66.1	-64.8	-66.6
Blerjet e mëdha pritje (pyetja 9, komponent i TBK-së)	-50.6	-52.4	-53.6	-54.3	-54.9	-54.3	-52.5	-49.7	-47.4
Kursimi aktual (pyetja 10)	-47.2	-48.0	-49.3	-48.4	-49.6	-48.2	-48.1	-42.5	-48.8
Kursimi pritje (pyetja 11)	-45.8	-46.3	-45.7	-44.3	-44.7	-44.4	-42.2	-41.1	-41.8
Situata e të ardhurave dhe shpenzimeve (pyetja 12)	0.1	0.1	1.7	2.4	1.1	1.1	2.0	1.4	1.3

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

ANEKS

Shpjegime metodologjike

Balanca është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vërtetimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

Treguesi i Besimit (TB) ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve, të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE) ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para agregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.